

VENDIM
Nr. 116, datë 22.7.2019

**MBI MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-ve PËR NJË
METODOLOGJI TË PËRBASHKËT TË RRJETIT NË PËRPUTHJE ME NENIN 17
TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2015/1222 TË DATËS 24 KORRIK 2015,
QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES MBI ALOKIMIN E KAPACITETIT DHE
MENAXHIMIN E KONGJESTIONEVE”**

Në mbështetje të neneve 7, 16, 19, 23, 56, 65 dhe 67, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar, nenit 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, neneve 58, 62, 64 dhe 104, të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017 dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., është anëtar me të drejta të plota i Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit për Energjinë (European Network of Transmission System Operators for Electricity; (ENTSO-E), bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve,

konstatoi se:

- Me vendimin e bordit nr. 88, datë 31.5.2019, ERE ka filluar procedurat për miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve”.

- “Propozimi i të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve”, u përcoll për miratim nga OST sh.a me shkresën nr. 2035 prot., datë 15.3.2019, protokolluar me tonën 228 prot., datë 18.3.2019.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, përkatësisht neneve 7, 16, 19, 23, 56 65 dhe 67, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186 datë 10.11.2017, kapitulli IV në tërësi dhe nenit 64 të “Modeli i rrjetit për D-1 Dhe D” në veçanti; nenit 104 të “Modelet individuale të rrjetit, modelet e bashkuara të rrjetit dhe analizat e sigurisë operative”.

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me krijimin e një metodologjie të modelit të përbashkët të rrjetit.

- Dokumenti i përbërë nga 24 nene me kërkesa specifike mbi modelin individual të rrjetit, skenarët, modelin e përbashkët të rrjetit, parametrat e cilësisë së MIRR-aë (Modeli Individual i Rrjetit) dhe MPRR-së (Modeli i Përbashkët i Rrjetit), blloqet baze të modelit, procesin e bashkimit të modeleve individuale, impaktin e pritur në objektivat e Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 dhe merr parasysh sigurinë operationale, optimizimin në llogaritjen dhe shpërndarjen e kapacitetit ndërzonar duke siguruar trajtim të drejtë dhe jodiskriminues të pjesëmarrësve të tregut si dhe duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e informacionit.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga European Network of Transmission System Operators for Electricity (ENTSO-E) dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të

gjithë OST-të dhe interkoneksionet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

- ERE, në vijim të vendimit nr. 88, datë 31.5.2019, dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, me shkresën nr. 32/28 prot., datë 6.6.2019, publikoi për tre ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure. Në përfundim të afatit të njoftuar, rezultoi që nuk kishte asnjë koment apo opinion nga palët e interesuara

- Me shkresën nr. 228/2 prot., datë 13.06.2019, ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, për dhënie mendimi lidhur me propozimin e mësipërm.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo opinioneve rezultoi se, Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës me nr. 382/2 prot., datë 2.7.2019, është shprehur se draft propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar .

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Propozimin e të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 17 të rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve”.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti